



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas



Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Datë:	15.11.2022
Nga:	Znj. Laureta Thaqi
Për:	Kryetarin e komunës, z. Ramiz Lladrovci
Lënda:	Raport lidhur me vizitën zyrtare në ShBA

I nderuar kryetar z. Lladrovci,

Në vijim gjeni të përmbledhur raportin lidhur me vizitën zyrtare në ShBA në kuadër të programit "Open World" të Ambasadës Amerikane, të financuar nga Zyra e Kongresit për Udhëheqësi Ndërkombëtare.

Komuna e Drenasit është përzgjedhur në mesin e komunave të Kosovës për të marrë pjesë në programin "Open World" që financohet nga Zyra e Kongresit për Udhëheqësi Ndërkombëtare, me temën "Pjesëmarrja e të rinjve në Proceset Vendimmarrëse" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.. Delegacioni i Kosovës është përzgjedhur nga Ambasada Amerikane, dhe ka pas këtë përbërje: liderë nga komunat, Drenas, Ferizaj dhe Lipjan, si dhe përfaqësues të Organizatave Jo qeveritare nga po këto komuna. Përzgjedhja është bërë nga Ambasada Amerikane, kurse Zyra e Kongresit ka bërë aprovimin, ku edhe janë filluar pastaj procedurat e përgatitjes për vizitën si agjenda e takimeve, aspektet logjistike etj. Programi është mbajtur në ShBA, përkatësisht në Uashington DC dhe Iowa State, nga data 26 Tetor deri me 9 Nëntor.

Historik: Si është formuar programi “Open World” dhe pse shërben?

Zyra e Kongresi për Udhëheqësi Ndërkombëtare menaxhon programin “Botë e Hapur”, program ky që është vlerësuar si më efektiv për shkëmbimin e përvojave mes ShBA-së dhe vendeve të epokës pas sovjetike.

Qëllimi i këtij programi që administrohet nga COIL është të paraqes para udhëheqësve të rinjtë të vendeve pas sovjetike rëndësinë e funksioneve legislative në krijimin e demokracisë së qëndrueshme. E themeluar në vitin 1999 nga Kongresi, Zyra e Kongresit për Udhëheqësi Ndërkombëtare, e njohur me parë si Qendra e Liderit Botëror të Hapur, përfshinë shtetet si Rusia, Ukraina, Azia Qendrore, Evropa Lindore dhe vendet e tjera të Ballkanit.

Struktura e këtij programi është:

- Kongresi i ShBA-së
- Këshilli i Administrimit
- Zyra e Kongresit për Udhëheqësinë Ndërkombëtare
- Grantmarrësit Kombëtar- Iowa Sister States
- Mikpritësit Vendor- Familjet Amerikane

Kush është organizata “Iowa Sister States” dhe pse shërben?

Iowa Sister States është organizatë vullnetare jofitimprurëse me qendër në Des Moines në Iowa. Kjo organizatë ka për synim krijimin e partneriteti të qëndrueshëm ndërkombëtar, të cilat mundësojnë lidhjen e qytetarëve iowas me bashkësinë botërore. Pra, zbatimin e partneritetit dhe programe ndërkombëtare që promovojnë interesa kulturore, ekonomike, dhe të tjera të shtetit të iowas, dhe qytetarëve.

Vizita në ShBA ka nisur me 27 tetor në qytetin Uashington DC me disa takime të cilat janë realizuar bashkë edhe me delegacione të shteteve të tjera si: Azerbajxhan, Moldavia, Taxhikistan, Kazakistan dhe Uzbekistan. Fillimisht, u pritëm nga znj. Jane Sargus, Drejtore Ekzekutive në

Zyrën e Kongresit për Udhëheqësinë Ndërkombëtare. Znj. Sargus duke na uruar mirëseardhje në Uashington DC, ajo theksoi se përmes këtij programi, si liderë në vendimmarrje, do të kemi mundësinë e shkëmbimit të përvojave më të mira të përfshirjes së të rinjve në proceset publike, qytetare dhe politike.

Pas saj, nga Dr.Sam Potolicchio, President në Fondacionin për Përgatitjen e Udhëheqësve Global, Profesor në Universitetet Geogertown, Mannheim, dhe Bologna, u informuam më shumë për udhëheqjen në kontekstin e Kulturës Amerikane, për karakteristikat e një lideri, mënyra e vendimmarrjes në kontekstin e kulturës amerikane, etj. Nga ai patëm mundësi të shohim edhe dy shembuj konkret lidhur me këtë temë.

Për Kulturën Amerikane, ligjëratë mbajti Dan Davidson, Drejtor i Qendrës për Kërkime i Këshillave Amerikan, dhe Këshilltar Akademik i Lartë, i cili paraqiti elementet të cilat e karakterizojnë kulturën amerikane. Kurse, Dr. Jame M. Quirk, nga Departamenti për Qeverinë Amerikane, dhe Universitetin Amerikan, ligjëroi për Federalizmin Amerikan. Pas takimeve dhe sesioneve informuese, bashkë me delegacionet e tjera vizituam institucionet e Qeverisë Amerikane, si Shtëpia e Bardh, Kongresi, Libraria e Kongresit, etj.

Agjenda e takimeve në Iowa State, Des Moines

Me datë 28.10.2022 kemi udhëtuar për në Iowa State, Des Moines, ku jemi pritur nga Todd Jacobuson nga Komitetit të “Iowa State Sister”, njëherit koloneli i Gardës Kombëtare të Iowas dhe pjesëmarrësit e tjerë të programit, përkatësisht familjet mikpritëse amerikane.

Të hënën, me 31 Tetor, në Iowa, kapitolin e Shtetit jemi pritur në takim nga Sekretari i Shtetit, Paul Pate dhe Legjislativi Ndërkombëtar i Iowas, përkatësisht Senatorja, znj. Annette Sweeney. Në këto dy takime të ndara, jemi informuar për mënyrën se si të rinjtë dhe gratë janë të përfshirë në vendimmarrje, zgjedhjet e 8 nëntorit 2022, organet legjislative, etj. Gjithashtu, kemi bërë një vizitë të institucioneve si senati, Zyra e Guvernatorit, Gjykata Supreme, Auditori, Thesari etj.

Në Des Moines, kemi vizituar edhe shkollën e mesme “Hoover”, ku jemi pritur nga drejtoresha znj. Qynne Kelly, për të diskutuar sfidat lidhur me udhëheqjen e shkollës e cila ka një diversitet të nxënësve të vendeve të ndryshme të botës, dhe ku fliten mbi 44 gjuhë të huaja. Znj.Kelly njoftoi për strukturën organizative, dhe si të rinjtë janë pjesë kyçe e vendimmarrjes në menaxhment. Gjithashtu, jemi takuar me z.Jason Alleen nga Shkollat Publike të Des Moines dhe znj. Cory

Jackson nga Wellmark Blue që organizuan Samitin e Diversitetit në vitin 2019 ku morën pjesë 250 të rinjë udhëheqës nga 15 shkolla të mesme.

Të martën, me 1 Nëntor, kemi vazhduar takimet në qytet tjetër, në **Council Bluffs**, ku jemi pritur nga Presidenti i Këshillit Conuncul Bluffs, z. Bryan Carolus dhe Mathhew Schultz nga po ky këshill. Në këtë takim jemi informuar për programin për të rinjtë, artet, kulturën dhe sportin në këtë pjesë të Iowas, përkatësisht Kolegjin Komunitar Perëndimor të Iowas. Jemi takuar me z. Andrew Fetter të organizatës “Atletikë e pakufizuar”, dhe z. Justin Shultz nga Bordi i Mbikëqyrësve të Distriktit “Pottawattami”. Gjithashtu, kemi pasur mundësinë të dëgjojmë nga znj. Nicky Clark për organizatën “Elevate Omaha” e cila organizatë mbështetet nga bizneset në Council dhe bënë shumë punë vullnetare për komunitetin, sidomos tenton të bëjë të dëgjohet zëri i rinisë, si pjesa më aktive e shoqërisë. Prej saj morëm shembuj të ndryshëm për aktivizimin e rinisë në komunitet.

E mërkurë, me 2 Nëntor, takimet zyrtare janë zhvilluar në qytetin **Fort Dodge**, ku jemi pritur nga z. Chad Schaeffer nga Zyra për Zhvillim. Ideja e takimit ka qenë shkëmbimi i përvojave me udhëheqjen atje, dhe përfshirjen e të rinjve në komunitetin perëndimor të Iowas. Po ashtu, kemi pasur takim me znj. Jill Nelson, Drejtoreshë për Zhvillim të Komunitetit në organizatën “Greater Fort Dodge Growth Aleance & Junior Leadership Program”. “Greater Fort Dodge Growth Alliance” është një organizatë e cila ka për mision unifikimin, dhe koordinimin e përgjegjshëm ekonomik dhe zhvillimit të komunitetit për përmirësimin e cilësisë së jetës në Fort Dodge, Iowa dhe me gjerë. Programi ‘Junior Leadership’ i Fort Dodge është krijuar për të informuar dhe angazhuar të rinjtë e shkollave të mesme për atributet pozitive dhe lehtësitë në rajonin e Fort Dodge duke u ofruar pjesëmarrësve përvoja dhe ligjerata edukative. Në këtë mënyrë, ky kolegji synon të nxisë tek ta krenarinë dhe shpirtin e komunitetit, pra ta duan dhe të punojnë për komunitetin.

Takimet kanë vazhduar me Dr. Jeese Ulrich, President i Kolegjit Komunitar Qendror të Iowas, dhe z. Jeffrey Halter, Koordinator i programeve për edukim. Në këto dy takime u informuam për mënyrën si të rinjtë janë të përfshirë në proceset vendimmarrëse, në dy nivelet, mikro pra në nivel kolegji dhe makro, të nivele më të larta (grupe të adoleshentëve dhe grupe të rinjve). Gjithashtu, me znj. Jolene Hays, Këshilltare e Shkollave të Mesme në Fort Dodge, e cila është edhe koordinatore e programeve të shkëmbimit mes shkollave të Fort Dodge dhe Kosovës.

*Takimet kemi vazhduar në qytetin **Clarion**, aty ku jemi pritur nga kryetari i qytetit, z.Rod Heiden. Ai është zgjedhur udhëheqës në nëntor të vitit 2021, dhe ka qenë në Kosovë kur kanë arritur marrëveshje binjakëzimi me Junikun. Ai na ka uruar mirëseardhje dhe në pika të shkurta ka përmbledhur qeverisjen e tij në Clarion dhe binjakëzimin me komunën nga Kosova. Pas tij, z.Scott Simmons, Drejtor i Rekreacionit dhe z.Kevin Katz, Koordinator për Teknologji, ky i fundit njoftoi se të gjitha shkollat janë të pajisur me pajisje te teknologjisë për zhvillim të mësimi, dhe që të gjitha i monitoron përmes një softueri të veçantë. Gjatë takimit u diskutua mundësia që kurdo që pajisjet të cilat i kanë në përdorim shkollat dhe në një të ardhme të afërt i ndërrojnë, shprehen dëshirën që ato që funksionojnë mirë, t'i sjellin për nxënësit e Kosovës. Ajo që vlen të theksohet takimi me "Boys Scouts of America (BSA), organizatë e cila ofron për të rinjtë program për zhvillimin e karakterit, dhe trajnim për udhëheqje duke u bazuar në vlera, pra i ndihmon të rinjtë të përgatitën për jetën. Ajo çka mësuam nga kjo organizatë është për misionin e veçantë që kanë në përgatitjen e të rinjve për të bërë zgjidhje etike dhe morale gjatë jetës së tyre duke bërë betimi mbi vlerat sipas kësaj organizate me synimin për t'i bërë ata të përgjegjshëm. Programi përfshinte angazhim rreth mjedisit, shëndetit publik, edukimit, teknologjisë e shumë fusha të tjera. Që nga fillimin i tij në vitin 1910, më shumë se 130 milionë të rinjë kanë marrë pjesë në programet rinore të BSA-së.*

*Të enjten, 03 Nëntor, vizitën studimore e kemi vazhduar në qytetin e Iowas (**Iowa City**) në klubin "Rotary Youth Leadership Award" (RYLA). Në këtë takim jemi pritur nga anëtarë të kësaj organizate, përkatësisht z.Steven A.Wieneke i cili na njoftoi më shumë për aktivitetet e shërbimit humanitar që kanë bashkë me liderët e bizneseve. Rotary është organizatë jopolitike, dhe në gjithë botën janë mbi 46,000.00 klube e me anëtarësim prej 1.4 milionë njerëz, të njohur si Rotarianët. Pas tij, informata me ne delegacionin ndanë edhe folës të tjerë, vullnetare të klubit. Çdo anëtar është në gjendje t'i propozojë një projekt Bordit të Drejtorëve, por të gjitha projektet duhet të ndjekin një proces aplikimi dhe shqyrtimi. Në mënyrë që klubi të ketë ndikimin më të madh në komunitetin e Iowa City, Bordi i Drejtorëve të Klubit mund të zgjedhë të ndryshojë ose kufizojë mbështetjen midis shumë projekteve të mbështetura nga anëtarët. Motoja e Rotarit e "Shërbimi mbi vetveten" është e dukshme në mënyrat e shumta që Rotaria e qytetit të Iowa-s është përfshirë në përpjekjet ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien, arsimin dhe shkrim-leximin. Në projekte përfshihen shumë të rinjtë e Iowas. Pas diskutimet mbi*

programet e shumta të klubit Rotary, u mirëpritëm nga Distrikti 6000. U diskutua për bashkëpunimin në krijimin e klubeve të tilla edhe në komunat e Kosovës.

Të premten, 04 Nëntor, Des Moines. Todd Jacobuson, anëtarë i komitetit të distrikti të pavarur të shkollave në Des Moines na informoi për mënyrën se si është krijuar komiteti dhe pse shërben. Ky komitet përbehet nga një drejtor shkolle, një studentë dhe një anëtar i caktuar nga drejtori me qëllim të qasjes ndaj sfidave në shkolla nga një perspektivë më e gjerë, kërkime dhe procese të drejtuar nga faktet. Pra, bëjnë monitorim të shkollave dhe hartojnë raporte mbi bazën e fakteve që hasin në shkolla duke marrë masa, si shembull renovime të shkollave apo të tjera.

Gjithashtu, kemi pasur mundësinë të vizitojmë Universitetin “Drake”, ku u pritëm nga Drejtori Ekzekutiv, z.Scott Raecker, i cili bëri një përmbledhje të programit “Character Counts”, programit “Honor”, etj dhe për jetën e Guvernatorit Billie Ray. Programi “Character Counts”, ndihmon në krijimin e komuniteteve të forta dhe pozitive, marrëdhënie të shëndetshme në komunitet dhe sjellje të përgjegjshme. Misioni i këtij programi nisi në vitin 1997 për përmirësimin e civilizimit përmes zhvillimit të karakterit dhe universiteti i Ray u bë shtëpia e “Character Counts” në vitin 2019 dhe i shërben komunitetit të kampusit universitar Drake përmes programeve speciale, kërkimeve dhe angazhimeve akademike. Këtë program e bënë të veçantë vlerat të cilat duhet edhe anëtarët t'i kenë për tu anëtarësuar si: Besueshmëria, Respekti, Përgjegjësia, Drejtësi, Kujdes dhe Qytetari. Ndërsa, programi “Honor”, ndihmon trajnerët dhe drejtorët e atletikës që të promovojnë zhvillimin fizik, mendor, social dhe moral të studentëve-atletëve.

Në fund të ditës, takimet zyrtare dhe vizita studimore përfundoi në konsullatën e Kosovës në Des Moines, ku u pritëm nga z.Artan Duraku, dhe shumë familje të tjera amerikane të cilat e duan miqësinë e ShBA-së me Kosovën. Në këtë pritje të organizuar nga konsullata, dhe Organizata “Iowa Sister States”, ndamë përvojat e programit dhe shprehëm falënderime për familjet amerikane të cilat na mirëpritën dhe hapën dyert e shtëpive tyre gjatë qëndrimit në Des Moines.

Ky program është hartuar nga Ambasada Amerikane, ndërsa është mbështetur nga Zyra e Kongresit për Udhëheqësi Ndërkombëtare. Programi në Iowa State është planifikuar dhe organizuar sipas agjendës nga organizata “Iowa Sister States”.

Përmes këtij programi ndër të tjerash kemi fituar njohuri për çështje si:

- Metodot dhe teknikat e Kongresit për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje;

- Udhëheqja në Kontekstin Global, kultura dhe federalizmi amerikanë;
- Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse;
- Organizimi i të rinjve në nivele mikro dhe makro të vendimmarrjes/Këshillat rinor;
- Përfshirja e të rinjve në aktivitete për komunitetin;
- Funksionimi i organizatave dhe lidhja me komunitetin e biznesit.
- Kultura amerikane duke qenë se kemi jetuar në familjet amerikane

Cilat janë përfitimet e komunës nga ky program:

- Mundësitë e krijimit të partneritetit me ndonjë organizatë apo akterë që kemi takuar atje;
- Aplikimin e praktikave që përdorën në ShBA për përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse;
- Mundësia e aplikimit të ndonjë projekti/përvoje të fituar në Kosovë, në komunat ku shërbejmë;
- Mundësia e aplikimit në grante për të realizuar ndonjë projekt për komunën, përkatësisht të rinjtë etj.

Falënderime

Kryetarin e komunës, z.Ramiz Lladrovci për mbështetjen e pakursyer për pjesëmarrjen në këtë program si vendimmarrëse e re në komunën e Drenasit

Ambasadën Amerikane për përzgjedhjen e komunës së Drenasit për të marr pjesë në këtë program e Botës së Hapur të sponsorizuar nga Zyra e Kongresit për Udhëheqësi Ndërkombëtare (COIL) me temën “Përfshirja e Rinisë në Proceset Vendimmarrëse”.

Organizatën “Iowa Sister States”, përkatësisht z. Todd Jacobuson për programin dhe agjendën e takimeve në Des Moines

Vullnetaren amerikane, znj.Teresa Parmenter e cila lehtësoi qëndrimin në Iowa, dhe miqësinë e ngushtë me Kosovën.

Shtojcë: Fotografi nga takimet gjatë vizitës studimore në Uashington DC, dhe Iowa State







